



## MEMORANDUMBASHKËPUNIMI

### Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. Renelual Tahiri SH.P.K., Adresa: *Joni 92/2*. Prizren R. eKosovës, me NRB 810610099.

### Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI-Prishtinë dhe Renelual Tahiri SH.P.K.-Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

### Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Renelual Tahiri SH.P.K.-Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi Renelual Tahiri SH.P.K.-Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparataturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.



3. Kolegji Biznesi do të mbështes, Renelual Tahiri SH.P.K. -Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomis dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet Renelual Tahiri SH.P.K..

#### Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

#### Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

#### Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

### PALET NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

  
/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi  
Dekan



RENELUAL TAHIRI SH.P.K..

  
/Refik Hoxha  
Direktor



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 02/12/2020

